VENDIM
Nr.34, datë 20.5.2010

PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS, ORGANIKËS DHE KATEGORIZIMIT TË POZICIONEVE TË PUNËS TË ZYRËS SË KOMISIONERIT PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës, nenit 21 të ligjit nr. 10221, datë 4.2.2010 "Për mbrojtjen nga diskriminimi" dhe të neneve 9 e 10 të ligjit nr.9584, datë 17.7.2006 "Për pagat, shpërblimet dhe strukturat e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe të institucioneve të tjera të pavarura, të krijuara me ligj", të ndryshuar, me propozimin e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Miratohet struktura e Zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, sipas lidhjes nr. 1 bashkëlidhur.

II. Miratohet organika dhe kategorizimi i pozicioneve të punës të Zyrës së Komisionerit nga Diskriminimi, sipas lidhjes nr. 2 bashkëlidhur.

III. Paga e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi është në raportin 0,66 të pagës së Presidentit të Republikës së Shqipërisë.

IV. Efektet financiare të pagës së Komisionerit fillojnë nga çasti i marrjes së detyrës.

V. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE
Jozefina Topalli (Çoba)

Lidhja nr. 1

STRUKTURA E ZYRËS SË KOMISIONERIT
PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI



Lidhja nr.2

ORGANIKA DHE KATEGORIZIMI I POZICIONEVE TË PUNËS
TË ZYRËS SË KOMISIONERIT PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Funksioni	Nr. i punonjësve	Kategoria/Klasa
I. Komisioneri	1	
Këshilltar	1	II - b
Sekretar/specialist arkiv-protokolli	1	IV - a
II. Drejtoria e Çështjeve Procedurale, **Ligjore dhe Marrëdhënieve me Jashtë**	**(6)**	
Drejtor	1	II - b
Specialistë	5	III - b
III. Drejtoria e Hetim - Inspektimit	(5)	
Drejtor	1	II - b
Inspektorë	4	III - b
IV. Sektori i Marrëdhënieve me Publikun	(2)	
Përgjegjës sektori	1	III – a/1
Specialist	1	IV – a
V. Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse	(7)	
Drejtor	1	II - b
Specialist i burimeve njerëzore	1	IV - a
Specialist financë-buxhet	1	IV - a
Specialist IT	1	III - b
Magazinier/ punonjës mirëmbajtjeje	1	Kl. (*VKM 717, dt.6.2009)*
Shofer	1	Kl. “
Pastrues	1	Kl. “
Gjithsej	23 punonjës	